



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIM

Nr. 141, Datë 06.09.2017

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A., NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “ç” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5, pika 1 gërma “d”; 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e Shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatohet se:

Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., me shkresën nr. 3322/1 Prot., datë 11.05.2017, protokolluar në ERE me nr. 385/1 prot., datë 12.05.2017, kaparaqitur kërkesën për t’upajisur me licencën në aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike.

Bordi i ERE me vendimin nr. 86, datë 07.06.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike

Aplikimi i Shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” simëposhtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a/b”, “c” “d” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a” “b”, “c” dhe “f”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Licencimin e Shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., nëaktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, përnjëafat 5(pesë)- vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI